



Dalës-Izlazna

Nr. 111-302 Data 19.10.2018
Br. Datum

OBILIQ:OBILIC

Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

N J O F T I M

Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Obiliqit se nga data **19.10.2018** do të jetë në **DISKUTIM PUBLIK**:

Draft - Rregullorja për mënyren dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës Sportive “Adem Jashari” në Obiliq

Palët e interesuara kopjet mund të i marrin në zyrën e drejtorit të DAP-së në ndërtesën e komunës, ose përmes web faqes së komunës www.rks.gov.net/Obiliq.

Vërejtjet eventuale mund të dërgohen me shkrim në Zyrën e Drejtorit të DAP-së.

Me 19.10.2018
Obiliq

Drejtori i DAP-së

Përparim Klinaku





Комуна и Обилиќ-Општина Обилиќ
KOMUNA E OBILIQIT-OPSTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRQJITHSHME
UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE

Dalës-Izlazna

Nr. 111-302
Br.

Data 19.10.2018
Datum

OBILIQ-OBILIC



Republika e Kosovës-Republika Kosovo- Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

OB A V E S T E N J E

Obavestavaju se gradjani Opstine Obilic, da od dana **19.10.2018** bice **JAVNA RASPRAVA:**

NACRT - PRAVILNIKA o nacinu i uslovima koriscenja Sportske Salle “Adem Jashari” u Obilicu

Zainteresovane stranke mogu nabaviti kopije u kancelariji Direktora Opste Administracije u zgradi opstine ili u ueb sajtu opstine www.rks-gov.net Obilic.

Eventualne primedbe mogu se pismeno poslati u kancelariji Direktora Opste Administracije.

Dana 19.10.2018
Obilic

Direktor OA

Përparim Klinaku





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

**RREGULLORE (KO) NR ____ 2018 PËR MËNYRËN DHE
KUSHTET E SHFRYTËZIMIT TË PALESTRËS SPORTIVE
“ADEM JASHARI” NË OBILIQ**

Obiliq
Tetor 2018

Në bazë të nenit 10, nenit 12 paragrafi 2 shkronja c) si dhe nenit 40 paragrafi 2 shkronja a) të Ligjit nr.03/L-40 për Vetqeverisje Lokale, nenit 85, pika 2 e Statutit të Komunës së Obiliqit Nr.I-34 e dt.25/04/2016 si dhe nenit 1.3 dhe 1.4 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017 Për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, Kuvendi I komunës së Obiliqit në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. _____ 2018 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR MËNYRËN DHE KUSHTET E SHFRYTËZIMIT TË PALESTRËS SPORTIVE "ADEM JASHARI" NË OBILIQ

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen mënyrat dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës së Sporteve aktivitetet sportive të klubeve të regjistruara në Federatat gjegjëse, manifestimeve të ndryshme të kulturës, tubimeve partiake, revistave rekreacionit si dhe grupeve të tjera joformale.

Neni 2 Përkufizimet

1. DKRS – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

2. Objekt sportiv - nënkupton objektin ku ndodhen zhveshtoret, restoranti, hapësirat teknike dhe logjistike, fusha sportive me të gjitha pajisjet tjera mbështetëse.

Neni 3 Funksionimi i objekteve sportive

1. Funksioni primar i objekteve sportive është që të krijoj kushte për zhvillimin e aktiviteteve sportive, rekreative, koncerte, tubime dhe ngjarje tjera të organizuara.

2. Në palestër mund të zhvillohen ndeshje dhe stërvitje të sporteve të cilat janë të përshtatshme vetëm për ambiente të mbyllura si: Basketboll, Hendboll, Volejball, Futsall dhe sporte tjera të licencuara.

3. Në palestër mund të zhvillohen aktivitete tjera sportive të cilat vlerësohen si jo të rrezikshme për dëmtimin e dyshemesë dhe të ambienteve tjera.

4. Në palestër mund të zhvillohen aktivitete promovuese dhe tubime nga fusha politike.

Neni 4
E drejta për shfrytëzimin e Palestrës sportive

Të drejtë shfrytëzimi në palestrën sportive kanë: Institucionet shtetërore, klubet sportive, organizatat politike, organizatat joqeveritare, bizneset, institucionet shkollore, Universitetet, institucionet ndërkombëtare si dhe grupe tjera formale dhe joformale.

Neni 5
Mënyra e shfrytëzimit të Palestrës sportive

Mënyra e shfrytëzimit të palestrës sportive rregullohet me anë të marrëveshjes së arritur të palës së interesuar me menaxherin e objektit të palestrës sportive, e cila nënshkruhet nga menaxheri i palestrës dhe palës së interesuar.

Neni 6
Kërkesa për shfrytëzim

1. Pala e interesuar për shfrytëzim të palestrës duhet të paraqes kërkesë së paku 3(tri)ditë para mbajtjes së aktivitetit.
2. Kërkesa i drejtohet me shkrim menaxherit të palestrës sportive (DKRS), i cili obligohet për të kthyer përgjigje me shkrim brenda 24 orëve.
3. Klubet sportive të komunës të Obiliqit të cilat janë të licencuara në Federatat gjegjëse dhe që kanë kalendarin e rregullt të garimeve nuk i nënshtrohen paragrafit 2.

Neni 7
Rregullat themelore për shfrytëzimin e objekteve sportive (rendi shtëpiak)

1. Për pakënaqësitë eventuale, shfrytëzuesi duhet të drejtohet me ankesë në DKRS.
2. Menaxheri i palestrës ka të drejtë të suspendoj përkohësisht shfrytëzuesin e sallës për mos respektimin e kriterëve të përcaktuar në marrëveshje dhe rregullave sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje deri në vendimin tjetër të DKRS-së.
3. Shfrytëzuesi i palestrës duhet të identifikohet dhe të regjistrohet çdo herë para shfrytëzimit të palestrës dhe të respektojë orarin e caktuar në marrëveshje me personat përgjegjës në palestër.
4. Ndalohet pirja e duhanit në të gjitha hapësirat brenda palestrës.
5. Pas shfrytëzimit të hapësirave në palestër dhe zhveshtoreve, kujdestarët kontrollojnë hapësirat për të verifikuar gjendjen.
6. Klubet dhe individët duhet vet të kujdesen për gjërat e tyre personale, menaxhmenti në palestër nuk mban përgjegjësi për gjërat e humbura apo të dëmtuara.
7. Shfrytëzimi i palestrës bëhet me pagesë sipas tarifës së caktuar me këtë rregullore, përjashtim bëjnë vetëm subjektet e liruara.
8. Pajisjet që përdoren në palestër nga sportistët duhet të jenë të përshtatshme me ambientin e palestrës. Përrjashtohen rastet kur ka ndonjë marrëveshje të posaçme me DKRS-në.
9. Ndalohet hyrja në parket me këpucë të papastra që lënë gjurmë.

10. Shitja e rekuizitave, pijeve, ushqimeve dhe gjërave tjera në objektin sportiv është e ndaluar.
11. Klubet sportive duhet të sjellin orarin e tyre për shfrytëzimin e palestrës të menaxherit të palestrës.
12. Fëmijët nën moshën 16 vjeçare duhet të jenë nën përcjellje të prindit apo kujdestarit të tyre.
13. Ndalohet hyrja me kafshë në palestër, përjashtohet rasti kur kafsha i ndihmon personit me aftësi të kufizuara.
14. Në zhveshtore nuk lejohet asnjë lloji i pijeve alkoolike, pijeve me ambalazh qelqi, ndërsa lejohen pijet freskuese të lojës.
15. Ndalohet hyrja në palestër me bicikleta, skateboard apo çfardo mjete tjetër transportues, përjashtimisht personat me aftësi të kufizuara.
16. Ndalohet hyrja me armë, përjashtim bëhet vetëm për personat e autorizuar të sigurisë në detyrë.
17. Ndalohet vendosja e posterëve dhe njoftimeve tjera pa leje me shkrim nga ana e menaxherit të palestrës.

Neni 8 Vendosja e reklamave

1. Subjekteve të interesuara u mundësohet vendosja e reklamave të tyre me këto dimensione dhe tarifa mujore:
 - 1.1. Në qendrën e fushës së basketbollit-futcall në parket.....150 Euro
 - 1.2. Në gjysmërrethin e reketit të fushës së basketbollit-futcallit.....50 Euro
 - 1.3. Në hapsirën e 7-metërshit të fushës së futcallit.....2x0.60m.....50 Euro
 - 1.4. Në hapsirën brenda fushës së basketbollit dhe hendbollit2x0.60 m.....50 Euro
 - 1.5. Rreth vijave të fushës së basketbollit dhe hendbollit.....3x0.60m.....40 Euro
 - 1.6. Në pjesën anësore (veriore dhe jugore, në muri) të palestrës.....3x0.60m.....40 Euro
 - 1.7. Në pjesët tjera të palestrës dimensionit.....2x0.60m.....20 Euro
2. Kohëzgjatja e vendosjes së reklamave në vendet e zgjedhura do të jetë deri në një vit, me të drejtë vazhdimi sipas kontratës së re.
3. Vendi i vendosjes së reklamës caktohet me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes.

4. Shpenzimet e shkrimit, vendosjes dhe zhvendosjes së reklamës i bartë subjekti i cili ka vendosur reklamën.
5. Pagesa për reklamën e ekspozuar bëhet çdo muaj dhe atë në fillim nga data 1-5 të muajit vijues.
6. Në palestrën sportive, klubet mund të ekspozojnë reklamat lëvizëse të sponsorëve të tyre vetëm gjatë orarit të ndeshjeve të tyre por me kusht që mos të pengohen reklamat ekzistuese në palestër.
7. Në rastet ku paraqiten dy ose më shumë kërkesa për reklamë në të njejtin vend, përzgjedhja bëhet me licitacion.
8. Palët që vendosin reklamat janë përgjegjës për dëmet eventuale që shkaktohen gjatë vendosjes dhe heqjes së tyre dhe obligohen që ti marrin përsipër të gjitha shpenzimet për riparimin e nevojshëm.

Neni 9

Dokumentacioni i nevojshëm për shfrytëzim të palestrës

1. Klubet e interesuara për zhvillimin e aktiviteteve të tyre të rregullta sportive duhet të sjellin te drejtori I DKRS-së , këto dokumente:
 - 1.1. Certifikatën e regjistrimit
 - 1.2. Certifikatën fiskale
 - 1.3. Lejen e njoftimit të personit përgjegjës
 - 1.4. Listën e anëtarëve (lojtarëve) të klubit
2. Klubet e regjistruara dhe menaxheri i palestrës pas shqyrtimit të kërkesës së klubit lidhin marrëveshje për shfrytëzimin e palestrës.
3. Subjektet tjera që nuk janë klube sportive të regjistruara, për shfrytëzimin e palestrës sportive duhet të paraqesin kërkesën për shfrytëzim.

Neni 10

Pagesat për shfrytëzimin e objekteve në palestër

1. Të gjitha klubet që janë të regjistruara në DKRS, respektivisht që janë të licencuara në Federatat gjegjëse, apo garojnë në kuadër të Federatave përkatëse e që janë nga komuna e Obiliqit, mund të shfrytëzojnë palestrën për stërvitje dhe garim në bazë të një orari të rregullt të rregulluar nga

përgjegjësi i palestrës në bashkëveprim me udhëheqësit e këtyre klubeve dhe të vërtetuara nga DKRS, sipas këtyre pagesave, kritereve:

- 1.1. Për stërvitje sportive pa pagesë (për një orë)
- 1.2. Për ndeshje zyrtare si vendas pa pagesë
- 1.3. Për grupet formale dhe jo formale komunale 15 euro pa ndriçim, 20 euro me ndriçim (1 orë)
- 1.4. Për stërvitje të klubeve private 10 euro pa ndriçim, 15 euro me ndriçim (1 orë)
- 1.5. Për zhvillimin e ndeshjes pa bileta 30 euro (1 orë)
- 1.6. Për zhvillimin e ndeshjes me bileta 20 % nga mjetet e inkasuara nga shitja e biletave
- 1.7. Të gjitha klubet sportive që nuk janë të Komunës së Obiliqit, të cilat për shkaqe të ndryshme janë të interesuara të shfrytëzojnë Palestrën sportive në Obiliq duhet të paguajnë 100 euro për një orë.
- 1.8. Garat komunale, regjionale dhe Republikane të organizuara nga shkollat e komunës së Obiliqit apo Drejtoria Komunale e Arsimit lirohen nga pagesa e shfrytëzimit të palestrës sportive.
2. Palestra sportive mund të shfrytëzohet edhe për manifestime dhe ngjarje të ndryshme sipas këtij kompenzimi:
 - 2.1. Për ngjarje komerciale (panaie, revy, ekspozita dhe të ngjajshme) 100 euro
 - 2.2. Për ngjarje humanitare pa pagesë (gratis)
 - 2.3. Për koncerte të ndryshme 30 % nga inkasimi i mjeteve prej biletave ose pagesë fikse sipas marrëveshjes

Neni 11 Masat ndëshkuese

1. Ndaj palëve të cilat nuk e respektojnë rendin shtëpiak dhe nuk i binden menaxhmentit të objektit sportiv do të merren masa ndëshkuese, suspendim i përkohshëm nga e drejta e shfrytëzimit të palestrës me kohëzgjatje të lirë për tu përcaktuar nga përgjegjësi i palestrës dhe nëse përsëritet më shumë se dy herë i njejtë veprim atëherë i merret e drejta për shfrytëzim derisa organizata ose klubi në fjalë është i përbërë nga të njejtë akterë.
2. Për dëmet eventuale të shkaktuara nga klubet apo subjektet tjera përkatëse përgjegjësia bie te shfrytëzuesi i cili e ka shaktuar dëmin, andaj kompenzimet duhet bërë në afat prej pesë (5) ditëve në xhironlogarinë e komunës së Obiliqit.
3. Dëmet e shkaktuara vlerësohen nga komisioni ad-hoc prej tre anëtarëve të emëruar nga DKRS-ja. Në rast të moskompenzimit të dëmeve në afatin e paraparë sipas paragrafit 2 të këtij neni, inicohet

procedura gjyqësore përmes përmbaruesit privat duke përfshirë edhe kamatën ligjore si dhe ndalesën për shfrytëzim deri në zgjidhjen e kontekstit.

II.DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 12 Zbatimi i Rregullorës

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje përgjegjës është Kryetari Komunës dhe Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport.

Neni 13 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja nr. _____ e datës _____ e cila ka rregulluar këtë çështje.

Neni 14 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 7(shtatë) ditë pas publikimit të rregullorës në ueb- faqen zyrtare të komunës së Obiliqit

Kryesuesi i Kuvendit

Burim Gërguri

Më dt. _____ 2018